



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Tiranë, më, .04.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR SHQYRTIMIN E VEPRIMTARISË TË AUTORITETIT TE MEDIAVE AUDIOVIZIVE (AMA) PËR VITIN 2018 DHE HARTIMI I DRAFTREZOLUTËS

- **Hyrje**

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim Raportin vjetor të AMA-s për vitin 2018 në mbledhjet e tij të datave 01.04.2019 dhe 16.04.2019.

Të pranishëm në seancën dëgjimore të datës 01.04.2019 për të bërë prezantim e raportit vjetor, si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputeteve ishin Kryetari i Bordit të AMA-s z.Gentian Sala, si dhe përfaqësues të tjerë të stafit drejtues: Vera Muço, Sara Xhumbari, Arben Muka, Urim Bajrami.

Komisioni caktoi relator për këtë çështje zotin Musa Ulqini.

- **Baza ligjore**

Bazuar në nenin 19, pika 14, dhe nenin 28 të Ligjit nr. 97/2013 “*Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar”, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raportin vjetor të punës për vitin 2018.

Komisioni përgjegjës, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën ia paraqet seancës plenare.

Miratimi i kësaj projektrezolute kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1, e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi***

Në përmbushje të një prej detyrave kryesore të tij, atë të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë, bazuar në nenin 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit, organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit, të cilën e paraqet në seancë plenare. Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2018, si dhe rekomandime, të cilat institucioni i pavarur duhet t'i ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2019.

- ***Diskutimi në komision***

Në paraqitjen e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2018, Kryetari i Bordit të AMA-s, z.Gentian Sala, u ndal në disa nga çështjet e rëndësishme të aktivitetit të AMA-s. Ndër pikat kryesore që kanë të bëjnë me arritjet e AMA për vitin 2018, në të cilat u ndal z.Sala dhe përfaqësues të tjerë të Autoritetit të Mediave Audiovizive, ishin:

- Ecuria e procesit të digjitalizimit;
- zbatimi i Kodit të Transmetimit, me fokus të veçantë mbrojtjen e fëmijëve, reklamat dhe komunikimet tregtare, programet audiovizive me karakter informimi për shëndetin etj.;
- mbyllja, për herë të parë, e të gjitha transmetimeve të paligjshme audiovizive numerike, analoge;
- lirimi i brezit 790-862 MHz ose ndryshe 800 MHz, si një hap i rëndësishëm, i cili i hap rrugë futjes së teknologjive dhe shërbimeve të reja *broadband mobile* në nivel kombëtar.
- nënshkrimi i memorandumeve të mirëkuptimit ndërmjet AMA-s dhe disa institucioneve, në mënyrë të veçantë me Autoritetin e Konkurrencës;
- veprimtaria e Këshillit të Ankesave.

Deputetët bënë pyetje dhe shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me zhvillimet në fushën e mediave audiovizive. Gjithashtu, në fjalën e tyre vlerësuan punën e bërë nga Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe kërkuan që AMA të vijojë të luajë një rol proaktiv në lidhje me sfidat dhe zhvillimet e këtij sektori, në mënyrë të veçantë lidhur me procesin e digjitalizimit.

Gjithashtu, Komisioni shprehu angazhimin për rritjen e bashkëpunimit me AMA-n, duke ofruar mbështetjen e tij maksimale.

Ndërkohë, në mbledhjen e datës 16 prill u diskutua dhe draftrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2018. Deputetët u njohën me draftrezolutën e përgatitur, e cila u lexua nga relatori, ku u përmbledhën dhe rekomandimet e Komisionit drejtuar AMA-s. Në përfundim të mbledhjes, komisioni me shumicë votash miratoi draftrezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitin 2018.

Musa ULQINI

Milva EKONOMI

Relator

Nënkryetar